

BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE - ALPEX SHA

VENDIM TEKNIK Nr. 5-C

Për

"Listën e Tarifave të ALPEX"

Në mbështetje të dispozitave të përcaktuara në Seksionin B.4.5 të kapitullit B të Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme, si edhe Seksionet G.5.5 dhe G.5.6 të kapitullit G të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.

ALPEX SHA Miratoi:

1. Vendimin Teknik për Listën e Tarifave të ALPEX.
2. Lista e Tarifave të ALPEX është miratuar nga ERE nëpërmjet vendimit Nr. 299 Datë 30.12.2024, për zonën e ofertimit të Republikës së Shqipërisë.
3. Lista e Tarifave të ALPEX është miratuar nga ZRrE nëpërmjet vendimit Nr. V_2638_2025 Datë 27.01.2025 për zonën e ofertimit të Republikës së Kosovës.
4. Të gjitha tarifat janë pa TVSH, si edhe taksa të tjera që mund të shtohen në lidhje me Shërbimet. Për më tepër nëse do të aplikohen këto taksa, ALPEX mund ti faturoj ato.

ADMINISTRATORI I ALPEX SHA

Sokol Dishnica

VENDIM TEKNIK Nr. 5-C

NENI 1

1. QËLLIMI, FUSHËVEPRIMI DHE PËRKUFIZIMET

- (a) Qëllimi i këtij Vendimi është të përcaktojë tarifat e aplikueshme nga ALPEX-i dhe afatet për shlyerjen e tyre.
- (b) Përkufizimet e këtij Vendimi Teknik kanë të njëjtin kuptim si ato të përmendura në dokumentin Përkufizimet Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat lidhur me Tregjet e ALPEX.

NENI 2

2. TARIFAT E APLIKUESHME NGA ALPEX PARAQITEN SI MË POSHTË:

Lista e Tarifave të ALPEX	Vlera e Tarifës	Monedha e shlyerjes për tregun e Shqipërisë	Monedha e shlyerjes për tregun e Kosovës
Tarifa Administrative	200 €	Lekë	Euro
Tarifa e Anëtarësimit për Anëtarin e Bursës	10,000 €	Lekë	Euro
Tarifa e Aderimit për Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit	7,000 €	Lekë	Euro
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës në Tregun e Ditës në Avancë	14,000 €	Lekë	Euro
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës në Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	8,000 €	Lekë	Euro
Tarifa Vjetore për Anëtarin Personal të Klerimit	3,000 €	Lekë	Euro
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit	6,000 €	Lekë	Euro
Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh në Tregun e Ditës në Avancë	0.090 €	Euro	Euro
Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh në Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	0.140 €	Euro	Euro
Tarifa Variabël e Klerimit për MWh në Tregun e Ditës në Avancë	0.020 €	Euro	Euro
Tarifa Variabël e Klerimit për MWh në Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	0.040 €	Euro	Euro
Tarifa e Tregtimit në Emër të Dikujt Tjetër	20 €	Lekë	Euro
Tarifa për API Përdorues	2,000 €	Lekë	Euro
Mirëmbajtja e Llogarisë së Klerimit për Anëtarin Personal	100 €	Lekë	Euro

Tarifa Administrimit të Letër Garancisë Bankare	50 €	Lekë	Euro
Tarifa vjetore Trainimit	200 €	Lekë	Euro
Tarifa e Provimit	100 €	Lekë	Euro
Certifikata dixhitale për përdorues	50 €	Lekë	Euro
Tarifa Teknike	2,000 €	Lekë	Euro

- (a) Për tregun e Kosovës të gjitha tarifat do të shlyhen në monedhën Euro.
- (b) Për tregun e Shqipërisë tarifat do të shlyhen në monedhën Euro për jo-rezidentet.
- (c) Për tregun e Shqipërisë Tarifat Fikse do të shlyhen në monedhën Lekë me kursin fiks të këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë në ditën e faturimit.
- (d) Mbi çdo tarifë do të aplikohet TVSH-ja.

NENI 3

3. TARIFA FIKSE ADMINISTRATIVE

- (a) Me dorëzimin e Aplikimit për Anëtarësim, Aplikanti duhet të paguajë Tarifën e aplikueshme Administrative.
- (b) Pagesa e tarifës së mësipërme, bëhet e plotë në llogarinë përkatëse të specifikuar nga ALPEX-i.
- (c) Tarifa Fikse Administrative është e pakthyeshme.

NENI 4

4. TARIFA FIKSE E ANËTARËSIMIT DHE TARIFA FIKSE E ADERIMIT

4.1 Tarifa Fikse e Anëtarësimit për Anëtarët e Bursës

- (a) Aplikanti, në mënyrë që të marr kapacitetin e Anëtarit të Bursës, duhet të paguajë Tarifën Fikse të Anëtarësimit në ALPEX, sipas Rregullave të ALPEX-it - Kushtet e Përgjithshme.
- (b) Pagesa e Tarifës Fikse e Anëtarësimit paguhet në mënyrë të plotë në të njëjtën kohë me nëshkrimin e Marrëveshjes për Anëtarësim në Bursë.
- (c) Tarifa Fikse e Anëtarësimit, është një tarifë hyrjeje në ALPEX, që paguhet vetëm një herë dhe është vetëm për anëtarët e rinj. Kjo tarifë paguhet në Llogarinë përkatëse të specifikuar nga ALPEX-i në Bankën për Shlyerje.
- (d) Tarifa Fikse e Anëtarësimit nuk do të rimburohet nëse Anëtari nuk aktivizohet në ALPEX.

4.2 Tarifa Fikse e Aderimit për Anëtarët e Përgjithshëm të Klerimit

- (a) Aplikanti në mënyrë që të marr kapacitetin e Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit, duhet të paguajë Tarifën Fikse të Aderimit në ALPEX, sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.
- (b) Pagesa e Tarifës Fikse e Aderimit paguhet në mënyrë të plotë me firmosjen e Marrëveshjes Kuadër të Klerimit. Tarifa Fikse e Aderimit, është një tarifë hyrjeje që paguhet vetëm një herë dhe është vetëm për anëtarët e rinj.
- (c) Kjo tarifë paguhet në Llogarinë përkatëse të specifikuar nga ALPEX-i në Bankën për Shlyerje.
- (d) Tarifa Fikse e Aderimit nuk do të rimburohet nëse Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit nuk aktivizohet në ALPEX.

NENI 5

5. TARIFA FIKSE VJETORE

- (a) Kjo tarifë lidhet me anëtarësimin për një periudhë një vjeçare të Anëtarit të Bursës për pjesëmarrjen në Tregjet e ALPEX-it, siç janë Tregu i Ditës në Avancë (DAM) dhe Tregu Brenda së Njëjtës Ditë (IDM) dhe të Anëtarit të Klerimit për pjesëmarrjen në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes.
- (b) Tarifa Fikse Vjetore i paguhet ALPEX-it, nga anëtarët si më poshtë vijon:
 - (i) Nga çdo Anëtar Burse
 - (ii) Nga çdo Anëtar Personal Klerimi.
 - (iii) Nga çdo Anëtar i Përgjithshëm Klerimi
- (c) Për vitin e parë, pagesa e Tarifës Fikse Vjetore, të pjesëmarrjes si Anëtar Burse dhe si Anëtar Klerimi, llogaritet në bazë proporcionale për periudhën nga data e Anëtarësimit, deri në fund të vitit.
- (d) Për çdo vit pasues të vitit të anëtarësimit, Tarifa Fikse Vjetore paguhet në mënyrë të plotë, dhjetë (10) Ditë pas fillimit të vitit kalendarik tek Llogaria përkatëse të specifikuar nga ALPEX-i në Bankën për Shlyerje.
- (e) Shuma e paguar e Tarifës Fikse Vjetore nuk do të rimburohet në rast të fshirjes, pezullimit ose dorëheqjes së Anëtarit të Bursës dhe Anëtarit të Klerimit, ose për shkak të mungesës së aktivitetit për çfarëdo arsye, gjatë vitit.

NENI 6

6. **TARIFAT VARIABËL PËR TREGTIMIN DHE KLERIMIN E TRANSAKSIONEVE**

- (a) Çdo Anëtar i Bursës i paguan ALPEX-it në mënyrë të plotë, shumat e mëposhtme si tarifa për tregtimin dhe klerimin e transaksioneve të bazuar mbi volumin e energjisë elektrike të tregtuar në Tregjet e ALPEX-it, siç janë Tregu i Ditës në Avancë (DAM) dhe Tregu Brenda së Njëjtës Ditë (IDM).
- (b) Tarifat variabël të aplikuara janë si më poshtë:
 - (i) Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh në Tregun e Ditës në Avancë
 - (ii) Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh në Tregun Brenda së Njëjtës Ditë
 - (iii) Tarifa Variabël e Klerimit për MWh në Tregun e Ditës në Avancë
 - (iv) Tarifa Variabël e Klerimit për MWh në Tregun Brenda së Njëjtës Ditë
- (c) Pagesa e Tarifave Variabël të Tregtimit dhe të Klerimit për Transaksionet kryhet në ditën e ardhshme të punës së Ditës së Klerimit (C+1) nëpërmjet Llogarisë përkatëse të Shlyerjes në Para të cilën Anëtarët e Klerimit të ALPEX mbajnë në Bankën për Shlyerje, të specifikuar në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes.

NENI 7

7. **TARIFA E TREGTIMIT NË EMËR TË DIKUJT TJETËR**

Kjo është një tarifë e cila do aplikohet kur aktivizohet parashikimi në kapitullin G.3 të Procedurës së Tregtimit.

- (a) Kjo tarifë aplikohet bazuar në kërkesën e Anëtarit të Bursës.
- (b) Kjo tarifë do të llogaritet për çdo urdhërporosi të blerjes dhe urdhërporosi të shitjes të Anëtarit të Bursës dhe për ditën D të livrimit.
- (c) Kjo tarifë do të paguhet tek Llogaria përkatëse të specifikuar nga ALPEX-i në Bankën për Shlyerje.

NENI 8

8. **TARIFA PËR SHËRBIMIN API**

Përdorimi i API në ALPEX nga Anëtarët e Bursës është e parashikuar në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Termat e Përgjithshme, në paragrafin F.4.3.6 ku Anëtari i Bursës mund të kërkojë hapjen e një Llogarie Përdoruesi për shërbimin API për hyrjen në ETSS si një shërbim shtesë.

- (a) Kjo tarifë është vjetore dhe do të llogaritet çdo vit në të njëjtën datë, për periudha të njëpasnjëshme 12 (dymbëdhjetë) mujore, deri në ndërprerjen e shërbimit me kërkesë të Anëtarit të Bursës.

- (b) Kjo tarifë do të paguhet tek Llogaria përkatëse të specifikuar nga ALPEX-i në Bankën për Shlyerje.
- (c) Shuma e paguar e Tarifës për shërbimin API nuk do të rimbursohet në rast të fshirjes, pezullimit ose dorëheqjes së Anëtarit të Bursës ose për shkak të mungesës së aktivitetit.

NENI 9

9. TARIFA FIKSE MUJORE PËR MIRËMBAJTJEN E LLOGARISË SË KLERIMIT

- (a) Kjo Tarifë aplikohet për Anëtarin Personal të Klerimit me qëllim mirëmbajtjen e Llogarisë së tij të Klerimit.
- (a) Pagesa e shumës duhet të kryhet në ditën e dytë të punës të muajit kalendarik që ndjek muajin referues nëpërmjet Llogarisë përkatëse të Shlyerjes në Para, të cilën Anëtarët e Klerimit të ALPEX mbajnë në Bankën për Shlyerje, të specifikuar në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes.

NENI 10

10. TARIFA FIKSE MUJORE PËR ADMINISTRIMIN E LETËR GARANCISË BANKARE

- (a) Kjo tarifë aplikohet kur kemi të bëjmë me depozitim ose zëvendësim të Letrës së Garancisë Bankare nga Anëtari i Klerimit.
- (b) Pagesa e shumës së detyruar kryhet nëpërmjet Llogarisë përkatëse të Shlyerjes me Para që Anëtarët e Klerimit mbajnë në Bankën për Shlyerje, të specifikuar në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes.

NENI 11

11. TARIFA VJETORE E TRAJNIMIT DHE TARIFA E TESTIMIT

11.1 Këto tarifa aplikohen për kandidatët;

- (a) Si Agjent Tregtar i Certifikuar i cili do të jetë përgjegjës dhe i autorizuar për të kryer tregtimin në emër të Anëtarit të Bursës, dhe
- (b) Si Agjent Klerues i Certifikuar i cili do të jetë përgjegjës dhe i autorizuar për të kryer operacionet e Klerimit dhe Shlyerjes në emër të Anëtarit të Klerimit.

NENI 12

12. CERTIFIKATA DIXHITALE

Për aksesimin në Platformat e Tregtimit dhe të Klerimit nga Agjentët Tregtar të Certifikuar si edhe nga Agjentët Klerues të Certifikuar ATHEX lëshon një certifikate dixhitale e cila do të rinovohet çdo vit, tarifën e së cilës do e mbledhë ALPEX.

NENI 13

13. TARIFA TEKNIKE

Tarifa Teknike do të aplikohet në bazë vjetore për mbështetjen teknike që ALPEX jep për Anëtarët e Bursës.

- (a) Për vitin e parë, pagesa e Tarifës Vjetore Teknike llogaritet në bazë proporcionale për periudhën nga data e Anëtarësimit deri në fund të vitit.
- (b) Kurse për çdo vit pasues do të paguhet në muajin Janar të çdo viti kalendarik tek Llogaria përkatëse të specifikuar nga ALPEX-i në Bankën për Shlyerje.
- (c) Tarifa Vjetore Teknike nuk do të rimbursohet në rast të fshirjes, pezullimit ose dorëheqjes së Anëtarit të Bursës.

NENI 14

14. HYRJA NË FUQI E TARIFAVE TË ALPEX

Ky Vendim Teknik i ndryshuar është në fuqi në 01/01/2025.

Ky Vendim Teknik do të publikohet në faqen zyrtare të internetit www.alpex.al